REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

PROJEKTI I AUTOSTRADES MILOT - MORINE

DOKUMENT PARA-KUALIFIKUES

19 DHJETOR 2011

Referenca: PROJEKTI I AUTOSTRADES MILOT - MORINE
REPUBLIKA E SHQIPERISE

Ministria e Puneve Publike dhe Transportit ("**MPPT**") e Republikes se Shqiperise ("**Shqiperia**"), me ane te kesaj, fton aplikimet para-kualifikuese ("**Aplikime Parakualifikimi**") nga ofertuesit e ardhshem (secili "**Ofertues I mundshem**") per kryerjen dhe perfundimin e nje koncesioni per operimin, mirembajtjen dhe permiresimin e autostrades Milot - Morine ("**Koncesion**").
Koncesioni do te jepet nepermjet nje procesi konkurrues tenderimi.
Eshte miratuar procedura e meposhtme parakualifikuese:
1. MPPT ka publikuar nje ftese per parakualifikim ne:
(a) faqen e internetit www.mppt.gov.al me 19 dhjetor 2011;
(b) Buletinin e Njoftimeve Publike me 19 dhjetor 2011;
(c) tre publikime te njepasnjeshme ne gazeten nderkombetare International Herald Tribune me 19 dhjetor 2011, dhe
(d) tre publikime te njepasnjeshme ne gazetat kombetare Panorama dhe Standard me 19 dhjetor, 2011.
2. Pas paraqitjes se Aplikimeve Parakualifikuese, Ofertuesit e mundshem do te vleresohen ne drejtim te kerkesave dhe kritereve te percaktuara ne Udhezimet per Ofertuesit e mundshem, ketu bashkangjitur
2.1.1 Ofertuesit e mundshem, qe vleresohen te kene permbushur kerkesat dhe kriteret e procesit parakualifikues, do te emertohen si "Ofertuesit e Parakualifikuar".
2.1.2 Ofertuesit e para-kualifikuar, do te ftohen te marrin pjese ne procesin e tenderit per koncesionin.
Aplikimet parakualifikuese, duhet te dorezohen deri ne 15:00 sipas ores lokale te Tiranes, me 15 shkurt 2012, ne adresen e treguar ne Shtojcen 1 (Detaje Aplikimit parakualifikues).
Aplikimet parakualifikuese do te vleresohen nga nje komision vleresimi i ofertave (Komisioni i Vleresimit te Ofertave) i percaktuar nga MPPT. Pritet qe Komisioni i vleresimit te ofertave te perfundoje vleresimin e tij brenda dates 24 shkurt 2012. MPPT, do te publikoje listen e Ofertuesve te kualifikuar ne Buletinin e Njoftimeve Publike brenda 30 ditesh nga dita e miratimit te vendimit te saj.
Ju lutem konfirmoni menjehere pranimin fizik apo shkarkimin korrekt te kesaj ftese per parakualifikim nepermjet e-mail- it ne adresen e-mail : *manjola.malo@mppt.gov.al*, dhe nje kopje per drejtuesit e transaksionit IFC-se ne adresen *okudashov@ifc.org*, e cila duhet te regjistrohet dhe te perfshihet ne listen e shperndarjes te pyetjeve dhe pergjigjeve (shih seksionin 2.8).

NJOFTIM I RENDESISHEM

Kjo ftese i behet marresit, vetem per perdorim ne pergatitjen dhe dorezimin e aplikimeve te Parakualifikimit ne lidhje me koncesionin. Ftesa behet vetem nga MPPT per t'u perdorur vetem nga Ofertuesit e mundshem te koncesionit. Ftesa eshte pergatitur me ndihmen e Korporates Financiare Nderkombetare ("IFC") si keshilltare per transaksionin e koncesionit.
As MPPT as IFC, dhe as keshilltaret e tyre perkates ose keshilltare nuk ofrojne ndonje perfaqesim ose garanci, te (shprehur apo te nenkuptuar) persa i takon saktesise ose teresise se informacionit te dhene ketu, ose ne ndonje dokument tjeter ne dispozicion te nje ofertuesi te mundshem ne lidhje me procesin e tenderit per koncesion, dhe as nuk do te kene pergjegjesi per kete ftese, ose per cdo komunikim tjeter me shkrim apo me goje qe i transmetohet nje Ofertuesi

te mundshem ne lidhje me vleresimin e mundshem te ofertuesit te koncesionit. As MPPT as IFC, as keshilltaret e tyre perkatese ose keshilltaret, nuk do te jene pergjegjes per te rimbursuar ose per te kompensuar nje ofertues te mundshem per cfaredo kostoje ose shpenzimi te shkaktuar nga ofertuesi i mundshem ne vleresimin apo veprimet e ndermarra prej tij si rezultat i kesaj ftese, ose ndryshe ne lidhje me koncesionin e parashikuar ketu.
Kjo ftese nuk perben nje kerkese per te investuar, apo pjesemarrje ndryshe ne koncesion.

UDHEZIME PER OFERTUESIT E MUNDSHEM

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

PROJEKTI I AUTOSTRADES MILOT – MORINE

DOKUMENT PARA-KUALIFIKIM

19 dhjetor 2011

1. Hyrje

Ministria e Puneve Publike dhe Transportit ("MPPT") e Republikes se Shqiperise ("Shqiperia"), me ane te kesaj, fton aplikimet parakualifikuese ("Aplikime Parakualifikimi") nga ofertuesit e mundshem (secili nje "Ofertues I mundshem") per kryerjen dhe perfundimin e nje koncesionI per operimin, mirembajtjen dhe permiresimin e Autostrades Milot - Morine ("Koncesion").

1.1 Autostrada Milot – Morine, Pershkrimi ("AUTOSTRADA")

Autostrada, eshte pjese e rrjetit kombetar rrugor. Duke lidhur Milotin, rreth 60 km ne verilindje te portit te Durresit ne Adriatik, me Morinen, ne kufi me Kosoven, rruga formon seksionin qendror te autostrades me te gjere Shqiperi-Kosove, duke lidhur Tiranen dhe Durresin me Kosoven.

E Ndertuar ne faza, Autostrada perbehet nga tre segmente, e ndertuar me standarte te ndryshme inxhinierike:

• Segmenti I: Milot - Rreshen (26 km), perbehet nga nje korsi e vetme me dy kalime,financuar nga Banka Boterore, IDA dhe Fondi i OPEC-ut. Lidhja eshte realizuar ne Milot me rrugen veri-jugore Tirane -Shkoder, e cila lidh kryeqytetin shqiptar me kufirin e Malit te Zi.

• Segmenti II: Rreshen Kalimash (61 km), perben nje autostrade me kater korsi ne terren malor, i ndertuar me financim te qeverise nga Bechtel-Enka Consortium ndermjet prillit 2007 - qershor 2009. Ajo perfshin nje tunel 5,6 km, me dy-kalime ne Thirre .

• Segmenti III: Segmenti Kalimash Morine (31 km), eshte nje rruge e perfunduar ne 2011 dhe kryesisht e perbere nga nje trase me kater korsi te dyfishta, me perjashtim te shtate urave te shkurtra te cilat jane me dy korsi.

Autostrada perfshin kryqezimet ne vijim: Milot, Rubik, Rreshen, Reps, Thirra, Kalimash dhe Kukes.

Qeveria e Shqiperise , aktualisht po realizon punime ndertimi ne (i) kryqezimin e Fushe Milot (ne km 0), qe lidh autostraden me rrugen Tirane-Shkoder, dhe (ii) dualizimin e 7 urave ne segmentin e III te autostrades. Punimet pritet te perfundojne deri ne kohen kur, koncesionari i ardhshem te marre persiper projektin.

1.2 Permbledhje e Kushteve Kryesore te Koncesionit

Koncesionari, subjekt i nje sere standardeve operacionale te mirepercaktuara per kryerjen e punimeve, do te jete pergjegjes per:

(a) operimin dhe mirembajtjen e Autostrades;

(b) operimin dhe mirembajtjen e tunelit te Thirres;

(c) funksionimin e nje sistemi te hapur taksash, mbledhjen e te ardhurave nga taksat

(d) punimet shtese per stabilizimin e pjerresive dhe masa mbrojtese per te parandaluar mbylljen e rrugeve, per permiresimin e sigurise ne rruge, dhe per te reduktuar gradualisht kostot e operimit dhe mirembajtjes se Autostrades.

Pervec kushteve te mesiperme O&M, koncesionari, do te jete i detyruar te ndermarre punimet e meposhtme per rehabilitimin dhe zgjerimin:

(e) ndertimi i sheshit te pagesave, per nje sistem "te hapur" taksimi;

(f) instalimin e rrethimit pergjate Autostrades;

(g) instalimin e ndricimit ne te gjitha kryqezimet;

(h) permiresimin e tre kryqezimeve ne segmentin e III-te te autostrades;

(i) ndertimin e vend shkembimit (kryqezimit) Kalimash;
(j) dualizimin (ndarjen ne dy korsi) te segmentit te I-re te autostrades, dhe
(k) ndertimin e nje ure dhe tuneli ne Kukes.

1.3 Te dhenat e projektit dhe Informacion

Ministria dhe keshilltaret e saj, kane perfunduar analizat e meposhtme, raporte te te cilave, do tu vihen ne dispozicion Ofertuesve te parakualifikur, ne nje vend (salle) me te dhena mbi projektin ("Salla e te dhenave"):
(a) Analizimi i trafikut dhe studimi i fizibilitetit te taksave, te cilat perfshijne llogaritjen e trafikut, pyetesore me perdoruesit e rruges, gatishmerine per te paguar studimin, intervista me kompanite e transportit, trafikun dhe parashikimin e te ardhurave;
(b) diagnostikim gjitheperfshires i gjendjes te autostrades, duke perfshire cilesine dhe vleresimin e shtrimit te rrugeve, diagnostikimin jo-cenues te urave, etj;
(c) studim gjeoteknik , i cili perfshin nje studim LIDAR, te te gjitha seksioneve gjeologjike komplekse te autostrades, Imazhe orto-foto, testimi i detajuar i terrenit, hedhja ne harte gjeologjike inxhinierike me shkalle te 1:1,000, si dhe identifikimin, perkufizimin, pershkrimin dhe klasifikimin e rrezikshmerise se te gjitha shpateve pergjate autostrades.
Vleresimet aktuale paraprake te mases totale te investimeve te reja kapitale, me perjashtim te mirembajtjeve te medha dhe zevendesimin e shtresave, jane mes 80 dhe 100 milione euro, per te gjithe kohezgjatjen e koncesionit.

1.4 Regjimi rregullator.

Ligji per Koncesionet e Shqiperise percakton nje kuader ligjor per projektet e koncesionit. Ai paraqet parimet dhe rregullat per dhenien e koncesionit te cilat jane transparente, te drejta dhe efektive, si dhe siguron qendrueshmeri per investimet te cilat, sipas natyres se sektoreve te perfshire, jane pergjithesisht te nje natyre afatgjate.

Ligji i Koncesioneve eshte shume i perafert me rekomandimet e guides UNCITRAL-it PFI. Ligji per Koncesionet permban, dispozita per te siguruar nje proces te drejte dhe transparent te perzgjedhjes, duke perfshire edhe parakualifikimin e ofertuesve, procedura per kerkimin e propozimeve, me nje terheqje te dallueshme ndermjet propozimeve teknike dhe financiare, mundesisht procedure me dy faza, publikimin e dhenies se koncesionit, perjashtime te kufizuara ne dhenien e koncesionit, pa procedura konkurrence, ekzistencen e procedurave te rishqyrtuara, parametrat per procesin e negociatave, etj.

Ligji per Koncesionet qe rregullon marreveshjet e projektit, jep udhezime te qarta persa i perket ceshtjeve kryesore qe do te mbulohen, te cilat ende mbesin mjaft fleksibel, duke lejuar palet te negociojne lirisht kushtet e saj. Per me teper, ligji u lejon huadhenesve njohjen te drejtave.

VKM nr. 27, ne menyre me te qarte, percakton hapat specifike ne nje proces te tenderit per dhenie koncesioni.

1.5 Konsorciumi - Anetaret Kryesues

Nje Ofertues i mundshem, mund te marre formen e nje konsorciumi (nje "**Konsorcium**") te perbere nga kompanite, firmat, organet e korporatave ose subjekteve te tjera ligjore. Cdo Konsorcium, do te caktoje dhe te autorizoje nje anetar kryesues, ("**Anetari kryesues**") per te perfaqesuar dhe lidh ne menyre te te parevokueshme te gjithe anetaret e Konsorciumit ne te gjitha ceshtjet qe kane lidhje me procesin e parakualifikimit dhe tenderimit, duke perfshire, por jo duke u kufizuar ne paraqitjen e aplikimit te parakualifikimit ne emer te Konsorciumit.

Anetari kryesues, duhet te kete interesa ne Konsorcium (dhe ne cdo mjet te inkorporuar nga Konsorciumi, per zbatimin e Koncesionit) e jo me pak se 20%.

1.6 Konsorciumi - Kufizimet e Pjesemarrjes

Asnje kompani apo forme tjeter enti ligjor, nuk mund te marre pjese ne dy ose me shume Aplikime Parakualifikimi, qofte individualisht ose si nje anetar i nje konsorciumi.

Asnje ofertues i mundshem, apo anetar i nje konsorciumi, nuk mund te kete kontroll mbi nje ofertues potencial apo anetar i nje Konsorciumi. Per qellimet e ketij dokumenti Parakualifikues, "kontroll" do te thote, fuqia per te zgjedhur shumicen e bordit te drejtoreve (apo trupa te tjere te ngjashem me te) ose ndryshe, te drejtoje menaxhimin dhe politikat e nje njesie ekonomike, direkt ose indirekt, qofte nepermjet zoterimit te votave, me kontrate apo ndryshe, dhe "duke kontrolluar" dhe "duke qene i kontrolluar" te kene kuptime reciproke.

1.7 Shpenzimet

Ofertuesi i mundshem, do te barte te gjitha shpenzimet qe lidhen me pergatitjen dhe dorezimin e aplikimit te vet per Parakualifikim, duke perfshire pa kufizim te gjitha kostot dhe shpenzimet qe kane lidhje me pergatitjen e pergjigjeve ndaj pyetjeve, apo kerkesave per sqarim te ofertuesit te mundshem.

2. Pergatitja parakualifikimi
2.1 Gjuha e aplikimit te Parakualifikimit

Aplikimi i Parakualifikimit, pergatitur nga ofertuesi i mundshem dhe e gjithe korrespondenca dhe dokumentat qe lidhen me aplikimin e parakualifikimit, do te paraqiten ne gjuhen angleze ose shqipe, sic eshte specifikuar ne Shtojcen 1, me perjashtimin, qe ndonje informacion i printuar paraprakisht (p.sh. broshura) te ofruara nga ofertuesi i mundshem, sipas seksionit 2.7 te kesaj ftese, mund te jete e shkruar ne nje gjuhe tjeter, me kusht qe ajo te jete e shoqeruar nga nje perkthim i vertetuar ne anglisht ne pjeset perkatese.

2.2 Dokumentet qe perbejne aplikimin Parakualifikues

Aplikimet per parakualifikim, paraqitur nga Ofertuesi potencial, duhet te permbajne dokumentet e meposhtme:

(a) Pjesa I - informacioni i kerkuar sipas nenit 2.3
(b) Pjesa II - dokumentet ose informacioni i kerkuar nga neni 2.4
(c) Pjesa III – Ne rastet kur, ofertuesi potencial eshte nje konsorcium, dokumentet e kerkuara, sipas nenit 2.5
(d) Pjesa IV - prokure, e kerkuar sipas nenit 2.6
(e) Pjesa V - opsionale, vecmas te lidhura ne literature te printuara paraprakisht, sipas kerkesave te nenit 2.7

Aplikimet e Parakualifikimit nuk duhet te permbajne cmime, ose lista cmimesh, apo cmime te tjera reference, normash dhe cmime per sipermarrje te projektit. Aplikimet e Parakualifikimit qe permbajne informacione te tilla cmimesh, do te refuzohen.

2.3 Pjesa I - Kriteret e Parakualifikimit

Ne Pjesen I-re te aplikimit per Parakualifikim, ofertuesi duhet te paraqese deshmi qe ai i ploteson kriteret parakualifikuese te percaktuara tek ("Kriteret e parakualifikimit").

2.3.1 Kriteret Parakualifikimi dhe dokumentet e kerkuara

Kriteret e Parakualifikimit	**Dokumentet / Formularet**
QC1: Teknike **Kriteri 1 - Pervoja e Pergjithshme** Gjate periudhes ndermjet 1 janar 2002 dhe afatit perfundimtar te dorezimit te aplikimeve te parakualifikimit, ofertuesit potencial, duhet te kete eksperience ne: (a) operim ne rruge me pagese takse (b) mirembajtje urash dhe autostradash (c) mirembajtje dhe operim tunelesh (d) ndertim autostradash, tunelesh dhe urash ne rolin e Kontraktuesit te Menaxhimit, Kontraktuesit, ose nenkontraktorit. Nese Ofertuesi i ardhshem eshte nje konsorcium, gjate periudhes ndermjet 1 janar 2002 dhe afatit te fundit te Dorezimit te Aplikimit per parakualifikim, Konsorciumi nepermjet eksperiences se kombinuar te anetareve te tij, duhet te kete eksperience, ne te gjitha fushat e mesiperme, ne rolet e Kontraktuesit, Kontraktorit te Menaxhimit, ose nenkontraktorit.	**DQC1**: Ne menyre qe te provoje se i permbush keto kritere, ofertuesi potencial, do paraqese kopje te kontratave, dhe/ose certifikatave te leshuara nga autoriteti qe e ka punesuar, ku te perfshihen te gjitha informacionet e kerkuara, si dhe te plotesoje formularin 1, te paraqitur ne Shtojcen 5.
QC2: Kriteri i 2-te teknik - Pervoje pune ne rruge me pagese Gjate periudhes ndermjet 1 janar 2002 dhe	**DQC2:** Ne menyre qe te provoje se e permbush kete kriter, ofertuesi i ardhshem,

afatit perfundimtar te dorezimit te aplikimeve te parakualifikimit, ofertuesit potencial, duhet te kete marre pjese si Kontraktor Menaxhimi ose Kontraktor, ne te pakten dy kontrata, te cilat te kene perfshire, apo te perfshijne, pergjegjesine per operimin e nje autostrade te dyfishte me te pakten 60 km gjatesi, ku te perfshihet mbledhja e taksave nga perdoruesit e rruges, te cilet, te kene patur apo te kene te pakten 5-se vjet performance te suksesshme. Nese Ofertuesi potencial eshte nje konsorcium, anetari kryesues, duhet te kete marre pjese si Kontraktor Menaxhimi ose Kontraktor, ne te pakten njeren nga keto dy kontrata.	duhet te paraqese kopie te kontratave dhe / ose certifikatave te leshuara nga autoriteti i punesimit , ku te perfshihen te gjitha informacionet e kerkuara, si dhe te plotesoje formularin 2 te paraqitur ne shtojcen 5.
QC3: Kriteri teknik 3 – Eksperienca ne mirembajtjen e rrugeve dhe urave. Gjate periudhes ndermjet 1 janar 2002 dhe afatit perfundimtar te dorezimit te aplikimeve te parakualifikimit, ofertuesi potencial, duhet te kete marre pjese si Kontraktor Menaxhimi ose Kontraktor, ne te pakten dy kontrata, te cilat te kene perfshire, apo te perfshijne pergjegjesine per mirembajtjen e nje autostrade me dy korsi per te pakten 60 km gjatesi, duke perfshire edhe mirembajtjen rutine dhe periodike si dhe riparimin e rrugeve, kanaleve dhe argjinaturave, dhe urave, te kene patur apo te kene te pakten 5-se vjet performance te suksesshme. Nese Ofertuesi I ardhshem eshte nje konsorcium, anetari kryesues, duhet te kete marre pjese si Kontraktor Menaxhimi ose Kontraktor ne te pakten nje nga keto dy kontrata.	**DQC3:** Ne menyre qe te provoje se e permbush kete kriter, ofertuesi i ardhshem, duhet te paraqese kopie te kontratave dhe / ose certifikatave te leshuara nga autoriteti i punesimit , ku te perfshihen te gjitha informacionet e kerkuara, si dhe te plotesoje formularin 3 te paraqitur ne shtojcen 5.
QC4: Kriteri Teknik 4 – Operimi me tunelet dhe Pervoja e Mirembajtjes Gjate periudhes ndermjet 1 janar 2002 dhe afatit perfundimtar te dorezimit te aplikimeve te parakualifikimit, ofertuesi potencial, duhet te kete marre pjese si Kontraktor Menaxhimi ose Kontraktor, ne te pakten dy kontrata, ne te cilen Ofertuesi i ardhshem te kete qene pergjegjes per opertimin dhe mirembajtjen e nje tuneli autostrade me gjatesi te pakten 2.5	**DQC4:** Ne menyre qe te provoje se e permbush kete kriter, ofertuesi i ardhshem, duhet te paraqese kopie te kontratave dhe / ose certifikatave te leshuara nga autoriteti i punesimit , ku te perfshihen te gjitha informacionet e kerkuara, si dhe te plotesoje formularin 4 te paraqitur ne shtojcen 5.

km, ne rastin e nje korsie te vetme, dhe 1.5 km gjatesi, ne rastin e nje tuneli me dy korsi, si dhe te kete patur apo te kete nje histori performance te suksesshme prej jo me pak se 5 vjetesh. Cdo tunel i tille autostrade, duhet te kete, sistem ventilimi, elektro-mekanik, menaxhim te trafikut, sisteme komunikimi dhe mbrojtjeje Nese Ofertuesi i ardhshem eshte nje konsorcium, te pakten nje anetar I tij, duhet te kete marre pjese si Kontraktor Menaxhimi ose Nenkontraktor ne keto dy kontrata.	
QC5: Kriteri Teknik 5- Pervoja ne ndertim Autostradash Gjate periudhes 1 janar 2004 deri ne momentin e Afatit perfundimtar te dorezimit te Aplikimit per Parakualifikim, Ofertuesi I Ardhshem, duhet te kete marre pjese si Kontraktor Menaxhimi, Kontraktor ose nenkontraktor ne te pakten tre kontrata, te cilat te kene perfshire apo te perfshijne ndertimin e autostradave, seicila me vlere te komponenteve te ndertimit se paku 70.000.000 Euro (shtatedhjete milion) apo ekuivalentin e kesaj vlere, dhe ne thelb ndertime te nje cilesie te kenaqeshme, (dmth te pakten 80%) e perfunduar. Si pjese e kontratave te mesiperme ose te tjera te zbatuara ndermjet 1 janarit 2004 dhe deri ne momentin e afatit perfundimtar per dorezimin e Aplikimit per parakualifikim, ofertuesit potencial duhet te kene pervoje ne veprimtarite e meposhtme kryesore te ndertimit sipas shkalleve ne vijim ne cdo periudhe ndermjet 1 Janarit 2004 deri ne afatin perfundimtar per dorezimin e Aplikimit per parakualifikim: • ndertimin e segmenteve te autostradave me nje gjatesi totale prej se paku 30 km brenda nje periudhe tre vjecare ne rolin e Kontraktues Menaxherit te Kontraktuesit, ose Nenkontraktorit; • ndertimin e urave te autostradave dhe / ose kanaleve kulluese me nje gjatesi totale prej se paku 800 metra, duke perfshire te pakten nje ure prej se paku 200 metra gjatesi, brenda nje periudhe tre vjecare, ne rolin e Menaxherit te Kontraktuesit, Kontraktuesit ose	**DQC5:** Ne menyre qe te provoje se e permbush kete kriter, ofertuesi i ardhshem, duhet te paraqese kopie te kontratave dhe / ose certifikatave te leshuara nga autoriteti i punesimit , ku te perfshihen te gjitha informacionet e kerkuara, si dhe te plotesoje formularin 5 te paraqitur ne shtojcen 5.

Nenkontraktorit, dhe • punimeve te sistemimit te shpateve (pjerresive) ne projekte te permasave dhe kompleksiteteve te ngjashme, duke perfshire ndertimin e mureve mbajtese dhe masave te bio inxhinierise dhe kontrollit te erozionit, kanaleve kulluese ne seksione autostradash me nje gjatesi totale prej se paku 20 km brenda nje periudhe tre vjecare ne rolin e Kontraktorit ose nenkontraktorit. Nese Ofertuesi I mundshem eshte nje konsorcium, Konsorciumi me pervojen e kombinuar te anetareve te tij, duhet te kete realizuar punimet kyce minimale ndertimit sipas normave minimale te specifikuara me siper.	
QC6: Kriteri i I-re Financiar Ofertuesi i ardhshem duhet te kete pasur nje vlere neto prej te pakten 50.000.000 EUR ose ekuivalentin e saj ne fund te tre vjecarit te plote financiar me te fundit. Nese Ofertuesi I ardhshem eshte nje konsorcium, Anetari Kryesor, duhet te kete pasur nje vlere neto prej te pakten 50.000.000 EUR dhe cdo anetar i Konsorciumit, kredencialet e te cilit jane perdorur per qellimin e plotesimit te kritereve parakualifikuese, duhet te kete pasur nje vlere neto prej te pakten 30.000.000 EUR ose ekuivalenten e saj ne fund te tre vjecarit te plote financiar me te fundit .	**DQC6:** Ofertuesi i ardhshem, ose nese Ofertuesi i ardhshem eshte nje konsorcium, cdo anetar i Konsorciumit, do te paraqese pasqyrat financiare te audituara dhe te vertetuara rregullisht nga nje kontabilist i Licensuar publik per tre vitet e fundit , te plota financiare, per te cilat deklarata te tilla jane ne dispozicion, duke perfshire Bilancin e konsoliduar , pasqyren e te ardhurave, pasqyren e fluksit monetar dhe shenimet shoqeruese. Ofertuesi i ardhshem do te jape nje permbledhje te vleres se fitimit neto ne formularin 6 te paraqitur ne Shtojcen 5.

2.3.2 Njohja e Kontratave

Per nje kontrate qe do te njihet si deshmi e pervojes se nevojshme keto dy parime duhet te jene te verteta:
(a) ofertuesi potencial, duhet te kete zoteruar ose te duhet te zoteroje te pakten 20% te vleres se pergjithshme te kontrates gjate periudhes se kohezgjatjes se saj , ku kerkesat persa i perket pervojes te jene permbushur;
(b) ne lidhje vetem me QC5, kontrata duhet te jete te pakten 80% e perfunduar ne kohen e paraqitjes se kerkeses per parakualifikim.

2.3.3 Pjesemarrja e anetareve te tjere ne Kompanine e Projektit

Cdo anetar i Konsorciumit, kredencialet e te cilit jane perdorur per qellimin e plotesimit te kritereve parakualifikuese do te kete pjesemarrje te konsiderueshme (jo me pak se 10%) ne kapitalin e kompanise se projekti ose cdo Ent tjeter qe do te krijohen me qellim zbatimin e koncesionit .

2.3.4 Permbushja e kritereve te Parakualifikimit nepermjet nje Bashkimi

Aplikuesi (ose nese aplikanti eshte nje konsorcium, apo anetare Konsorciumi) mund te zgjedhe te paraqese prova (perfshire pasqyrat financiare) nga nje Bashkim, me qellim permbushjen e kushteve Financiare (te percaktuara ne QC6 me lart).
Aplikuesi (ose nese aplikanti eshte nje konsorcium, apo anetar Konsorciumi) mund te zgjedhe te paraqese provat e punimeve dhe sherbimeve nga nje Bashkim me qellim permbushjen e kritereve teknike.
Per qellimet e ketij dokumenti Parakualifikimi, nje "**Bashkepunetor**" nenkupton cdo subjekt qe e kontrollon ne menyre te drejtperdrejte apo indirekte, kontrollohet nga, ose eshte nen kontroll te perbashket me aplikuesin. Per qellimet e ketij dokumenti Parakualifikimi, "**kontroll"** do te thote pushteti per te zgjedhur shumicen e bordit te drejtoreve (ose organe perberese te ngjashme) ose ndryshe qe drejtojne ne menyre direkte apo indirekte menaxghimin dhe politikat e nje enti, nepermjet zoterimit te shumices se letrave me vlere, me kontrate apo ndryshe, dhe **"duke kontrolluar**" dhe "**i kontrolluar**" kane kuptime te lidhura reciprokisht.

Nese ndonje kriter kualifikimi, teknik apo financiar, eshte zbatuar nga ana e ndonje subjekti qe eshte Bashkepunetor i Aplikantit, Aplikanti, ne kete rast duhet te paraqese dokumenta qe vertetojne se nje subjekt i tille, permbush kushtet e Bashkepunetorit, sic jane parashikuar me siper.

Per qellimet e mesiperme, Bashkepunetori, duhet te paraqese nje leter Mbeshtetese, sipas formes se bashkengjitur ne Shtojcen 7.

2.4 Pjesa II – Formulari i Parakualifikimit dhe dokumente te tjera.

Ne Pjesen II te aplikimit per parakualifikim, secili ofertues potencial duhet te paraqese sa me poshte:
(a) nje Aplikim per Parakualifikim te nenshkruar nga ofertuesi i ardhshem (ose ne qofte se ofertuesi i ardhshem eshte nje konsorcium, nga anetari Kryesues) ne formularin e Shtojces 2.
(b) dokumentet e meposhtme ligjore dhe informacione :

(i) informacion baze per ofertuesin e ardhshem (apo cdo anetar te Konsorciumit) sic detajohet ne shtojcen 4, duke perfshire sipas dates, listen e aksionereve te ofertuesit potencial qe zoterojne nje interes pronesie me shume se 5% tek Ofertuesi potencial.
(ose nje liste per cdo anetar te konsorciumit);

(ii) aktet nenligjore te ofertuesit potencial (ose te akteve nenligjore per secilin anetar te Konsorciumit) dhe cdo amendament qe ka lidhje, dhe

(iii) nje ekstrakt te vlefshem te Regjistrit Tregtar te Ofertuesit te ardhshem (apo nje ekstrakt te vlefshem per secilin anetar te Konsorciumit).

(c) nje deklarate garancie sipas permbajtjes se shtojces 6, qe konfirmon se Ofertuesi i ardhshem, ose cdo anetar i Konsorciumit:
(I) nuk eshte ne falimentim ose likuidim ;
(Ii) nuk eshte denuar per mashtrim, korrupsionin, marreveshje te fshehta ose pastrim parash ose per ndonje veper penale te kryer gjate kryerjes se veprimtarise profesionale, dhe
(Iii) nuk eshte ne dijeni te ndonje konflikt interesi apo konfliktesh potenciale te interesit qe rrjedhin nga kontratat e meparshme ose ato ekzistuese, ose marredhenie te cilat mund te cenojne materialisht aftesine e tij per te permbushur detyrimet sipas kontrates se koncesionit; dhe
(Iv) nuk ka pasur detyrime tatimore ose detyrime te papaguara ne lidhje me vendime penale apo shkelje ligji ne afat prej jo me pak se tre vjet para Fteses per parakualifikim.

2.5 Pjesa III - Dokumentet e Konsorciumeve dhe Kerkesat

Nese Ofertuesi i ardhshem eshte nje konsorcium, ky duhet te kete nje anetar kryesues, i cili eshte i autorizuar (me ane te nje prokure sic pershkruhet ne seksionin 2.6) nga te gjithe anetaret e tjere te Konsorciumit, per te vepruar ne emer te tyre dhe per te marre persiper nje sipermarrje, e cila nuk do te ndryshohet perberjen e Konsorciumit, pa marre pelqimin paraprak me shkrim te MPPT, pelqim i cili, nuk do te refuzohet pa arsye.

Ofertuesi i ardhshem, i cili deshiron te parakualifikohet si nje konsorcium, duhet te paraqese si Pjesen e III-te te aplikimit per parakualifikim, nje angazhim te shkruar ne formen e nje letre te ekzekutuar rregullisht nga perfaqesuesi ligjor i secilit anetar te Konsorciumit, e cila :

(a) konfirmon angazhimin e cdo anetari ndaj Konsorciumit, dhe
(b) identifikon anetarin qe do te marre rolin e Anetarit Kryesues ne emer te anetareve te tjere, me autoritetin per te perfaqesuar te gjithe anetaret e tjere.

2.6 Pjesa IV – AKTI I PERFAQESIMIT

Cdo ofertues I ardhshem (apo, nese ofertuesi i ardhshem eshte nje konsorcium, cdo anetar I Konsorciumit) do te paraqese si pjesen e IV –rt te aplikimit te parakualifikimit, nje Akt Perfaqesimi te shkruar, sipas permbajtjes se shtojces 3, te Noterizuar, ne te cilen te shprehet se, personi(at) qe nenshkruan Aplikimin e Parakualifikimit, e ka(kane) autoritetin per te nenshkruar.

2.7 Pjesa V – Materialet e printuara paraprakisht

Nese Ofertuesi i ardhshem deshiron te paraqese materiale te printuara paraprakisht (p.sh. broshura) rreth ofertuesit potencial apo anetareve te konsorciumit, materiale te tilla do te perfshihen vetem ne pjesen e V-te te Aplikimit te Parakualifikimit dhe do te jene te lidhura vec e vec.

2.8 Sqarime

Ofertuesi i ardhshem, i cili kerkon ndonje sqarim rreth Dokumentit te Parakualifikimit, kritereve te kualifikimit, ose per ndonje nga kerkesat e parashtruara ketu, mund te njoftoje me shkrim MPPT ne adresen e-mail treguar ne Shtojcen 1, dhe nje kopje drejtuar kryetarit te gurpit IFC .

Cdo kerkese per sqarim te Dokumentave te Parakualifikimit, duhet te merret me email ne cdo kohe para ores, 14.00 ne Tirane me date 1 shkurt, 2012. Kopje elektronike te pergjigjes (eve), duke perfshire edhe shpjegimin e pyetjeve, por jo e identifikimi**n** e burimit ("**DOKUMENT I PERGJIGJES SE PYETJEVE** ") do te dergohet ne nje ose disa raunde, tek te gjithe ofertuesit e mundshem te cilet kane konfirmuar marrjen e dokumentave te Parakualifikimit sic specifikohet ne letren hyrese.

2.9 Orari

Orari i vleresuar per leshimin e ketij dokumenti Parakualifikimi, me qellim nisjen e ftesave per pranim ofertash, emertohet ("**Kalendari i parashikuar**"):

KALENDARI TREGUES

Aktiviteti	Afati i fundit
Dokumenti Parakualifikimi leshuar	19 dhjetor 2011
Afati i fundit per Aplikimet e parakualifikimit	15 shkurt 2012
Shpallja e ofertuesve te parakualifikuar	24 shkurt 2012
Ftese per Oferta Leshuar per Ofertuesit e parakualifikuar	5 mars, 2012

**** Ky kalendar eshte paraqitur vetem per qellime udhezuese***

MPPT sipas gjykimit te saj dhe pa njoftim paraprak per Ofertuesit e mundshem, mund te ndryshoje kalendarin tregues. Ofertuesit e ardhshem, nuk do te mbeshtetet ne asnje menyre ne kalendarin tregues, dhe MPPT nuk do te mbaje asnje pergjegjesi persa i perket ndryshimeve ndaj kalendarit te parashikuar. MPPT njofton Ofertuesit e mundshem per cdo ndryshim ne kalendarin tregues.

2.10 Formati dhe nenshkrimi i aplikimit te parakualifikimit

(a) Cdo ofertues i ardhshem do te pergatise dhe dorezoje nje origjinal te aplikimit perkates te tij te parakualifikimit dhe numrin e kopjeve te specifikuara sic specifikohet ne Shtojcen 1. Ne rast te mosperputhjes ndermjet kopjeve dhe origjinalit, do te prevaloje origjinali.

(b) Origjinali dhe te gjithe kopjet e aplikimit te parakualifikimit, qe konsistojne ne dokumentat e renditura ne nenin 2.2, duhet te shtypet ose te printohen me boje te pashlyeshme. Personi ose personat e autorizuar posacerisht per te vepruar ne emer te Ofertuesi te mundshem duhet te nenshkruajne aplikimin e parakualifikimit duke:

(I) nenshkruar aplikimin origjinal te Parakualifikimit; dhe
(II) nenshkrimin e te gjitha faqeve te aplikimit origjinal te parakualifikim, pervec materialeveve te pandryshuar te printuara paraprakisht.

(c) Aplikimi perkates i parakualifikim, nuk do te permbaje ndryshime, korrigjime apo shtesa, pervec nese korrigjimet e tilla jane nenshkruar nga personi ose personat qe kane nenshkruar aplikimin e parakualifikimit.

3. Dorezimi i Aplikimit te Parakualifikimit

3.1 Siglimi dhe shenjimi i Aplikimit te parakualifikimit

(a) Ofertuesi i ardhshem duhet te nenshkruajne Kerkesen originale te Parakualifikimit dhe cdo kopje, ne zarfe te vecanta, secili permban dokumentet e specifikuara ne nenin 2.2, dhe ne zarfe do te shenoje si "**Aplikimi Parakualifikimi - Original**", "**Aplikimi Parakualifikimi – Kopje 1**",
" **Aplikimi Parakualifikimi - Kopje 2** "(**te gjitha te shenuara ne menyre te rregullt, sic pershkruhet ketu**), etj. Zarfat duhet te jene te mbyllur ne nje zarf te jashtem dhe do:

(I) te adresohen tek:
Ministria e Puneve Publike dhe Transportit

(ii) te permbajne fjalet:
